

FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

RREGULLORE MBI PUNËN E KËSHILLIT MBIKQYRËS TË FEDERATËS SË MUNDJES TË KOSOVËS

Sipas dispozitave të Nenit 29 paragrafi 3 të statutit të Federatës së mundjes së Kosovës. Bordi i Federatës së mundjes së Kosovës, në mbledhjen e vet të mbajtur më 06.10.2022 shqyrtoi dhe miratoi:

RREGULLORËN MBI PUNËN E KËSHILLIT MBIKQYRËS TË FEDERATËS SË MUNDJES TË KOSOVËS

Neni 1.


Me këtë Rregullore, rregullohet mënyra e punës të drejtat dhe obligimet, e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të FMK-se.

Neni 2

Këshillin mbikëqyrës e përbëjnë tre anëtarë, njëri prej tyre është kryetar.

Neni 3

Anëtarët e Këshillit mbikëqyrës i zgjedh Kuvendi nga radhët e delegatëve të Kuvendit apo edhe punëtor sportiv, të cilët janë punëtorë të dalluar sportiv dhe gëzojnë autoritet në FMK.



FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

Neni 4

Kryetari i Këshillit mbikëqyrës zgjidhet në Kuvendin e FMK-se i cili e udhëheq Këshillin mbikëqyrës. Këshilli mbikëqyrës vendimet e veta i merr me shumicë votash.

Neni 5

Mandati i anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës është 4 vjet dhe nuk është i kufizuar.
Mandati i Këshillit mbikëqyrës fillon menjëherë pas mbledhjes së Kuvendit zgjedhor.

Neni 6

Mbledhjet e Këshillit mbikëqyrës i konvokon kryetari në:

- Bazë të vlerësimit vetjak,
- Kërkesës së kryetarit të Bordit të FMK-se
- Kërkesës së më tepër se gjysmës së anëtarëve të Bordit ekzekutiv dhe
- Kërkesës së 2/3 të anëtarëve, delegatëve të Kuvendit.


Neni 7

Këshilli mbikëqyrës mbikëqyr punën e organeve të Kuvendit të FMK-se të përcaktuara me Statut në mes të dy Kuvendeve.

Mbi gjendjen e konstatuar dhe mendimin lidhur me masat e njofton kryetarin, organet e Bordit dhe Kuvendin e FMK-se dhe propozon masat për përmirësimin e gjendjes në suaza të dispozitave të Statutit dhe akteve të tjera të FMK-se, në veçanti ndjek realizimin e planit financiar, duke propozuar masa gjegjëse, të cilat janë obligative .

Neni 8

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës në seancë nuk mund të apstenojnë nga votimi.



FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

Neni 9

Në seancën e Këshillit Mbikqyrës mbahet procesverbal. Procesverbalin e mban Sekretari i përgjithshëm i FMK-se.

Neni 10

Për mos respektimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje nga ana e anëtarëve të Këshillit mbikqyrës, do të mirren masa adekuate disiplinore.

Neni 11

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit.

Prishtine
06.10.2022

KRYETARI I FEDERATES
SE MUNDJES TE KOSOVES

NAIM MUJA

